

**Prof. Dr. Boshko BOJOVIQ, Paris**

## **KULLA SHQIPTARE**

### **Varësia e Hilandarit (Mont Athos –Maja e Atosit) dhe Gjon (Jean) Kastriotit**

Pas zhdukjes së shteteve të fundit ballkanike dhe të feudalëve të tyre përballë pushtimit otoman, manastiret e Month Atosit (Majës Atos) duket se u privuan nga mbrojtësit e tyre tradicionalë. Ky rol do të përmbushet nga princat e vendeve vllahe- Moldavisë dhe Vllahisë. Me gjithë varësinë nga Porta e Lartë princat rumunë ishin të vetmit që ia dilnin të përmbushnin obligimin e mytevelis, si mbrojtës dhe ktitorë të komuniteteve të mëdha haxhiorite të përkëdhelur nga perandorët bizantinë, si dhe nga sovranët e tjerë të vendeve ballkanike. Edhe pse institucione bamirëse, në formë të ktitorateve, kishin një funksion tërësisht politik religjioz me qëllim të legjitimitimit të pushtetit princor. Përkundër ndihmës që merrte duke u dhuruar toka apo në formë financiare dhe për mbrojtjen që gëzonte, bashkësia e manastirit duhej të përmbushte dhe të kryente shërbimin e saj fetar, ad votam aeternam, të lutjeve për shëndetin e princit dhe të familjes së tij si dhe për pushimin e shpirtit të tij kur ai e lëshon këtë botë. Me qëllim që ky shpërblim liturgjik të mund të shtrihej gjeneratë pas gjenerate, princi duhej të siguronte përjetësinë e të mirave trashëguese edhe për pasardhësit e frontit të tij. Kësisoj u formuan këto institucione për një kohë të gjatë. Princat rumunë siguronin në këto rrethana protektoratin e tyre mbi Manastiret e Month Athos në mes të shekullit XV dhe të XVII' periodë kjo kritike e zhdukjes së shteteve ballkanike dhe paraqitja e Ruisë si mbrojtëse e kishave dhe manastireve ballkanike.

Fondacioni i dinastisë serbe që nga fundi i shekullit XII, manastiri i Hilandarit do të duhej të përfitonte një ndihmë dhe një mbrojtje shumë të kujdesshme të princave rumunë, posaçërisht të

Vllahisë, që nga fundi i shekullit XV, deri të gjysma e dytë e shekullit XVII. Të derdhura kryesisht në formë ndihme financiare, manastiri i Hilandarit kishte një favorizim nga princat e Vllahisë pasi që ndihma financiare vjetore ishte e barabartë apo më e lartë se sa e manastireve më të mëdha sikur që ishte ai i Mont Athos-it. Ky fakt del nga dokumentet që kemi në disponim.

Manastiret e mëdha athonites, sikurse ai i Hilandarit ( i cili gëzonte vendin e tretë ose të katërt në hierarkinë athonite) kishte një numër të madh aneksesh në formë të celulave skite dhe termite (askete) të tjera arbitronin me bashkësitë e murgjve më të mëdha apo më të vogla. Disa nga këto bashkësi kishin fituar një privilegj që lidhej me ndihmat princore të drejtpërdrejta. Në mesin e këtyre varësive përfshihej edhe ermiti i Shën Savës në Kariesë, seli e Protatonit dhe njëherit kryeqyteti i Malit të Shenjt. Edhe pse nuk ishin të vendosur një numër i madh i murgjve, prestigji i këtij ermiti serb i themeluar nga Shën Sava i cili, para se të bëhej murg, gëzonte titullin e princit dhe duhej të justifikonte këtë privilegj të princit. Varësi tjetër e Hilandarit, që gëzonte një përkrahje të ngjashme ishte edhe ermiti i quajtur Kulla shqiptare (Arbanaški pirg). Sipas dokumenteve që disponojmë ndihma në të holla vjetore e këtij skiti akordohej që nga viti 1512 dhe vazhdoi të paguhej deri në vitin 1544. Sa i përket origjinës së patronazhit rumun në vendin e lutjeve dhe të grumbullimit, donatori i parë vllah ishte Basarab Tepelus (1477 – 1481).

Shuma e ndihmës në të holla ishte 1.000 aspra, më shumë se 100 aspra për shpenzime të udhëtimit të murgjve të cilët shkonin për të kërkuar ndihmat në Targovishte në gusht të 1512. Më 1525 shuma qe ngritur në 1.200 si dhe 1000 aspra si përkrahje ndaj igumenit Maker<sup>1</sup>, përgjegjës i së quajturës bashkësi. Tri vjet më vonë, më 1528, ndihma në të holla arriti shifrën prej 3.000 si dhe 300 aspra të tjera të dhuruara nga princi Radu të Afumatit. Kjo shumë është konfirmuar edhe nga princi Radu Paisi në fund të hartës së tij të 9 shkurtit 1544 që gjithnjë është në Tergovishte<sup>2</sup>. Shihet se përkrahjet e princave të Vllahisë qenë

<sup>1</sup> Higoumene de Chilandar (1525-1526 et 1533).

<sup>2</sup> B. Bojovic, " La legitimisation du pouvoir princier et le patronage roumain sur le Mont Athos", in Arta istoriei-istoria artei. Academicanul Razvan Theodorescu la 65 de ani, Bucarest 2004, p. 37-48; id. "Chilandar et le Pays roumains. Continuite liturgique et institutionnelle fans les altes princiers (XVe-XVIIe siecles)", in Inchinar lui Petre S. Nasturel la 80 de ani (Recueil de travaux en l'honneur de Petre S. Nasturel), Baraila 2003, p. 146-147.

aplikuar për një kohë të gjatë për Kullën shqiptare si dhe në eremitin e Kajes e cila pranonte ndihmën në të holla vetëm në mes viteve 1528 dhe 1536, gjithnjë duke u bazuar në dokumente të njohura deri më tani. Është e vërtetë se shumica e dredhur për eremitin e Karjes është pak më e madhe në vitin 1528, në 3.500 aspra, çka nuk mund të vejë në dyshim pozitën e privilegjuar të Kullës shqiptare në krahasim me një institucion kaq prestigjioz siç ishte ai i Karjes. Në mesin e të varurve nga Hilandari, vetëm kyr Kosma ( i cili qëndroi pranë kishës së Shën Elisë në Majën Athos), personazh i shquar dhe i dashur nga princat Radu le Grand dhe Vlad le Jeune, kishte pranuar një ndihmë në të holla mjaft të madhe, 2.000 aspra më 1501 dhe jo më pak se 5.000 aspra në vitin 1510.

### **Kulla shqiptare (Arbanaški pîrg, tr. Arnavud birgazi)<sup>3</sup>**

E vendosur disa kilometra larg nga Hilandari, në drejtim të juglindjes, ky eremit gjendet mbi një lartësi që shikon drejt portës së vogël të manastirit. Në fillim emri që i është dhënë këtij eremiti kushtuar Shën Gjergjit, është edhe një donacion i Gjon Kastriotit (1407 – 1437), djali i të cilit Gjergji u gradua Skënderbeg. Më 1426 ai dhuroi në favor të Halandarit për dy fshatra Radostushe (Rostuše) dhe Trebishtit (pranë lumit Radika, në verilindje të Dibrës), me një kishë kushtuar Nënës së Shenjtë të Zotit, në Rostushë. Që më 1428 beu (feudali) shqiptar pati fituar një rentë të përgjeshme për këtë skit prej 80 florinjsh, si dhe katër adelfata<sup>4</sup> (αδελφάτα)<sup>5</sup>. Kontrata mbi pranimin ishte jetësuar me “Hieromuanen (murgeshën) Athanase” e cila ishte igumane(abateshë) e Hilandarit në këtë kohë<sup>6</sup>. Kjo blerje e të drejtës jetike ishte bërë në emër të Gjon Kastriotit dhe të katër djemve të tij : Stanishës, Reposhit, Konstantinit dhe Gjergjit. Një akt i dytë

<sup>3</sup> V. Petković, “Arbanaski Pîrg u Hilandaru”, Arhiv za arbanasku starinu, jetik i etnologia, I/1-2 (1923) pp. 197-199; A. Fotiq, Sveta Gora Hilandar u Osmanskom carstvu (VX-XVII vek), Belgrad 2000, pp. 247-248.

<sup>4</sup> S. Novaković Zakonski spomenici, Belgrad 1912, pp. 467-468 ; B. Korablev, “Actes de l’Athos V”, Actes sllaves de Chilandar, Vizantinskii Vremenik, 19 (1939-1949), n°82, I. 27; V. Mison, “Akti bratskog s’bora iz Hilandara”, Godisnjak Filozofskog Fakulteta u Skoplju, 4 (1939-1949), N°7, pp. 197-199

<sup>5</sup> ky term adelfata nënkupton një rentë jetike për një apo më shumë persona, që favorizon kryesisht ata që dhuronin toka të holla. Të konfrontuar me rrezikun që lidhej me otomanët, jo pak familje proncore dhe feudale detyroheshin të përfitonin nga kjo e drejtë jetike për të siguruar një rentë sigurie në rrjedhën e kohës.

<sup>6</sup> V. Mošin, M. Purković, Hilandarski igumani srednjeg veka, Beograd, 1999, p. 99, 114.

relativ me të njëjtën blerje jetike ishte bërë rreth vitit 1430, tash në emër të tre bijve Gjon Kastriotit, me përjashtim të Stanishës i cili ishte konvertuar në islamizëm rreth vitit 1428<sup>7</sup>. Njëri nga bijtë e tij, Reposhi, më i madhi, që vdiq më 1431, që varrosur në Ekzonarteksin e kishës së madhe të Hilandarit<sup>8</sup>. Ka gjasë që edhe ai ka qenë murg (ose së paku ishte në fazën e shprehjes së dëshirës së tij), në fund të jetës së tij. Nëse Reposhi i dha fund jetës së tij në Hilandar, me gjasë, si laik që ishte, sipas lejimit të së drejtës jetike të adelfatonit, në fakt, babai i tij Gjon Kastrioti duket se ka mbyllur sytë për herë të fundit në Kullën shqiptare ose në Hilandar, si murg<sup>9</sup>.

Në fakt, në ekzonarteks të kishës së Hilandarit, mbi murin verior, është gjetur mbishkrimi “Престави се раб божи Репош дукс иљирскии, 6939” (Këtu pushon shërbëtori i zotit Reposhi, duk i Pllarisë, 6939, = 1431). Gjithashtu edhe në një mbishkrim që tashmë i takonte Hilandarit, i ruajtur në Muzeun e Rumjancovskit në Moskë, mund të lexojmë: “Серо 2 (маја) престаџи се Кастриот мнишки же Иоаким монах” (Këtë 2 (maj) vdiq Kastrioti, që sipas rregullit quhej Joakim murgu)<sup>10</sup>.

Si do që të jetë, duket që feudali i madh shqiptar kishte mbajtur lidhje të ngushta me manastirin e shquar serb të Majës Athos, prej nga emri i ishte dhënë emri Kulla shqiptare pasi që e kishte blerë për gjithmonë, për nder të të birit Reposh dhe sigurisht edhe nga vet vendi ku gjendej, me qëllim që të mund të tërhiqeshin atje princat dhe feudalët të cilët e kishin zgjedhur për të jetuar në vetmi në Malin e Shenjt. Fakti që lidhet me blerjen jetike nënkupton gjithashtu të drejtën e shërbimit fetar në favor të nënshkruesit të këtij angazhimi. Kjo ndryshe mund të shpjegohet edhe me kujtimin e feudalit shqiptar duke i dhënë emrin Kulla shqiptare. Pranë këtij të Shën Gjergjit, fjala Shën Nikolla paraqitet në dokumentin e vitit 1525. Është e mundur që një tjetër kishëz është ndërtuar nga dhuruesi princor vllëh, çka do të shpjegonte faktin që përmendet në aktin e dhuruesit si “klitor i ri, mbrojtës dhe rinovues” i eremitit.

<sup>7</sup>M. Živojnović “Adelfati u vizantiji i srednjovekovnoj Srbiji”, Zbornik radova Vizantologskog instituta, 11 (1968) p. 248, n. 38.

<sup>8</sup>M. Spremić, Despot Djuradj Branković i njegovo doba, Belegrade 1994, p. 286

<sup>9</sup>R. Grujić “svetogorski aziliza srpske vladaoce i vlastelu posle kosovske bitke”, Glasnik Skopskog naučnog društva, 11 (1937), pp.81-82; V. Petković, art.cit, pp.197.

<sup>10</sup>R. Grujić, art.cit.,pp. 81-82

Në Vqifnamen e vitit 1569, në vend të Arnavud birgazi gjendet vetëm një vresht. A është e mundur që tashmë do të ishte rrënuar. Sido qoftë në shekullin XVIII<sup>te</sup> e rigjejmë eremitin (Арбанашки пир) mbi një litografi të Hilandarit më varësit e tij, e ekzekutuar në Moskë më 1575. Kulla shqiptare aty është paraqitur me kishën e saj, kullën e saj të fortifikuar, ndërtesat tjera shtesë dhe muri që e rrethonte<sup>11</sup>. Më 1671 dhe 1672 njëri nga popët Petronije, haxhi dhe anëtar i këshillit të të urtëve të Hilandarit, është edhe murg dhe banues i Kullës shqiptare, së cilës ai i dhuroi një libër dhe u pagua në riparimin e një vëllimi tjetër. Ai kishte bërë një dhuratë në vitin 1643 edhe për ripunimin e eremitit fqinj Shën Trinitea, si dhe për konstruktimin e paraklizionit të Shën Nikollës në Hilandar<sup>12</sup>.

Erermi me prejardhje mesjetare, përmendur në burime me emrin “Kulla shqiptare” aktualisht është shndërruar në gërmadhë. Ajo është identifikuar dhe studiuar nga arkitekti S. Nenadović<sup>13</sup>.

---

<sup>11</sup>D. Davidov “Manastir Hilandar na bakrorezima XVIII veka” Hilendarski Zbornik 2 (1971), pp. 155-158; S. Nenadović, “Hilendarski skit Svete Trojice na spasovoj vodi, Hilendarski Zbornik, 2, 109

<sup>12</sup>O. Tomić “Hilendarski skit Svete Trojice na spasovoj vodi” Hilendarski Zbornik 9 (1997), pp. 182, n. 65-68.

<sup>13</sup>S. Nenadović, Hilandar na grafičkim prikazima XVIIIi XIX stoljeća, Zbornik Zaštita spomenika kulture, XVI, Beograd 1965, pp 105-106; la representation graphique de l’hermitage est reproduite, en agrandidans. “Hilendarski skit Svete Trojice na spasovoj vodi” Hilendarski Zbornik 2 p. 109 S. Nenadović “Hilendarski skit Svete Trojice na spasovoj vodi” Hilendarski Zbornik, 2, p. Tb. 7 Voir aussi, M. Živojnović, Svetogorske kelije i pirgovi u srednjem veku, beograd 1972,pp.106-107.

